

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGTARE " Erudite Academy Albania " SH.P.K ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 07/04/2023, në Tiranë,

Marilda Salla shtetas shqiptar, i lindur më 09/08/1996 në Peqin, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr ID J65809020Q

I cili ka vendosur themelimin e shoqërisë **Erudite Academy Albania Sh.P.K.**, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqëria **Erudite Academy Albania Sh.P.K.**, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar. Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqësimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

NENI 2

Emri i shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **Erudite Academy Albania**

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:

Shërbime trajnimi për gjuhën angleze të përgjithshme dhe profesionale, shërbime përkthimi anglisht shqip/ shqip anglisht, konsulence për punësimin e karrierës, program trajnimi dedikuar karrierës dhe formimit profesional, trajnime për të folurit në publik, kurse online gjuhë anglisht, italisht dhe gjermanisht; ndërmjetësim për internshipet, përfaqësim i bizneseve/ kompanive të huaja dhe shqiptare dhe dhënia e asistencës për punësim, zhvillim projektësh, organizim eventesh dedikuar fushave të ndryshme profesionale, konferenca dhe trajnime mbi mesimdhëniën online dhe fizike, asistencë-konsulence studimesh, ushqyes arsimore, shërbime të IT, hapësira dhe ambiente të përbashkëta pune.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Tirane, Albania: Rruga e Kavajës 50 Ish Volkswagen, Tiranë 1001

MS

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i nje ortakut te vetem themeluesi i kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek.

Themeluesi merr në pronësi kuotën **100%** në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tij.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

Znj. Marilda Salla , 1 kuotë , me vlerë 100 Lek, zotëron 100 % (njëqind).

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetëm i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë Znj. Marilda Salla, shtetas shqiptar, i lindur më 09/08/1996, lindur në Peqin dhe banuese në Tirane), person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me ID J65809020Q


Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative:

- a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit
- b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

NENI 8



Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

NENI 9

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 10

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

NENI 12

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, te cilët e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKËT THEMELUES

MARILDA SALLA

